



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2020:130264

Datë: 01.04.2021

Numri i dokumentit: 01655313

C. nr. 617/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË KAMENICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Artan Abazi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K. nga, të cilin me autorizim e përfaqëson M.M., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson F. Z., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datën 11.03.2021 mori, ndërsa më datën 01.04.2021, e përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.K. nga dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në mënyrë të kundërligjshme, për periudhën kohore prej 30 ditëve pas datës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës, t’i paguajë paditësit 1 (një) pagë mujore në shumë prej 418.00 euro dhe atë sipas kontratës së punës me nr. 850/22, të datës 17.09.2013, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit I.K., përmes të cilës ka kërkuar që të vërtetohet se të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme dhe të detyrohet Komuna e Kamenicës – Drejtoria Komunale e Arsimit, ta kthej në punë dhe detyrat e punës si mësimdhënës i mësimi zgjedhor ku ka punuar në SHML “Ismail Qemali” në Kamenicë, ku ka qenë me kontratë të punës të pandërprerë deri më datën 31.08.2015 dhe ta sistemojë në SHMP “Andrea Durrsaku” në Kamenicë, për mësim zgjedhor për lëndët ekonomike për 10 orë mësimi dhe t’ia kompenzojë të ardhurat personale nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nga korriku 2015 e deri në kthimin në vendin e punës, me kamatë ligjore prej 8% duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë 08.02.2016, e deri në pagesën definitive, **REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi I.K. nga, përmes të autorizuarit të tij M. M., avokat nga Gjilani, me datën 17.06.2015, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komunës së Kamenicës - Drejtorisë Komunale të Arsimit (tutje DKA-së), të cilën me autorizim e përfaqëson F.Z., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti për kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale.

1. Pretendimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqjese

I autorizuari i paditësit avokati M.M., në seancën përgaditore të datës 19.01.2021, ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke shtuar se paditësi sipas konkursit të hapur nga e paditura me nr.284, të datës 03.08.2010, është pranuar si profesor i lëndëve ekonomike në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë, ku edhe të njëjtit ju ka vazhduar kontrata e punës edhe për vitet 2011/2012, 2012/2013, 2013/2014, 2014/2015, pra deri më 31.08.2015, ashtu që sipas të autorizuarit të paditësit pa kurrfarë paralajmërimi paditësit I.K. nuk i’u është vazhduar kontrata e punës, tutje ka shtuar se paditësi duke qenë i pakënaqur për mos vazhdimin e punës ka parashtruar ankesë në Inspektoriatin e Arsimit ku edhe të njëjtit i është miratuar ankesa si e bazuar, me qka sipas kësaj paditësi i ka plotësuar kushtet dhe meqënëse i ka pasur 3 vite përvojë pune dhe ka qenë i licensuar sipas udhëzimit administrativ të MASHT, me nr.06/2015, të datës 10.07.2015, ka mundur të punojë deri në vitin shkollor 2017/2018, duke pasur parasysh këtë i autorizuari i paditësit ka theksuar se paditësit I.K. i’u është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme. Ndërsa në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2021, i autorizuari i palës paditëse ka deklaruar se duke mbetur edhe më tutje pranë kërkesëpadisë, në këtë seancë e ka bërë ndryshimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv ashtu që nga gjykata ka kërkuar të aprovohet kërkesëpadija dhe padia e paditësit duke e vërtetuar se paditësit i’u është ndërprerë kontrata e punës në mënyrë të kundërligjshme dhe ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që paditësin I.K. ta kthejë në vendin e punës respektivisht në shkollën e mesme të lartë “Ismail Qemali” në Kamenicë, ku ka qenë me kontratë të punës të pandërprerë deri me datën 31.08.2015 dhe ta sistemojë në shkollën e mesme profesionale “Andrea Durrsaku” në Kamenicë për mësim zgjedhor për lëndët ekonomike për 10 orë mësimi dhe t’ia kompensoj të ardhurat personale nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës respektivisht nga korriku i vitit 2015 e deri në kthimin në vendin e punës, me kamatë ligjore 8 % duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive, ndërsa në fjalën përfundimtare i autorizuari i palës paditëse ka kërkuar nga gjykata se pas administrimit të të gjitha provave materiale të aprovohet padia dhe kërkesëpadija e paditësit dhe të obligohet e paditura që paditësin ta kthejë në vendin e punës dhe të njëjtit t’i kompensohen të ardhurat personale të kërkuara si më lartë, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 104.00 euro, si dhe në emër të përfaqësimit për 6 seanca gjyqësore, nga 135.00 për secilën për orën e parë ndërsa nga dy orë tjera 30% të pagesës bazë, e në shumë të përgjithshme 1.390.00 euro sipas Tarifës së Odës të Avokatëve.

I autorizuari i palës së paditur avokati F. Z., në seancën përgaditore të datës 19.01.2021, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjegjes në padi dhe kundërshtimeve të paraqitura në të dhe ka theksuar se nuk është kontestuese se paditësi ka pasur kontratë të punës me afat të

caktuar dhe atë deri më datën 31.08.2015, kur edhe i ka skaduar kontrata e punës dhe sipas të njëjtit konform nenit 67 të Ligjit të Punës dhe nenit 7 të Kontratës së tij të punës me nr.784/09, e datës 04.09.2014 paditësit I.K. me skadimin e kësaj periudhe kohore i është shkëputur kontrata e punës sipas fuqisë ligjore. Tutje i autorizuari i të paditurës ka shtuar se paditësi nuk ka qenë i kualifikuar për ta ushtruar funksionin e mësimdhënësit në arsimin e lartë, sepse e ka pasur të përfunduar fakultetin tre vjeçar bachelor. Poashtu ka shtuar se pas administrimit të provave të propozuara është vërtetuar fakti se pozita në të cilën ka qenë i punësuar paditësi dhe në të cilën kërkon të kthehet nuk ekziston dhe është shuar që nga viti 2016, ngase në bazë të njoftimit të lëshuar nga Gjimnazi “Ismail Qemali” në Kamenicë, me nr.19, të datës 19.01.2021, është konstatuar se lënda e ekonomisë si lëndë zgjedhore nuk ka qenë e paraparë në planprogramet mësimore të hartuara nga MASHT pas vitit 2015/2016, përkatësisht kanë qenë të parapara deri më 31.08.2016. Ndërsa në fjalën përfundimtare i autorizuari i palës së paditur ka deklaruar se paditësi me asnjë provë nuk ka mundur që ta provojë kërkespadinë e tij, dhe me qenëse se të njëjtit i ka skaduar kontrata sipas fuqisë ligjore, i autorizuari i të paditurës i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkespadija e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar, si dhe i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej 513.00 euro dhe atë në emër të përfaqësimit për tri séanca gjyqësore shumë prej 405.00 euro, për secilën prej 135.00 euro si dhe në emër të përpilimit me shkrim të fjalës përfundimtare shumë prej 108.00 euro.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova materiale: Konkursi me nr. 284, i datës 03.09.2010, i hapur nga Drejtoria Komunale e Arsimit, në Komunën e Kamenicës, Konkursi me nr. 50, i datës 18.02.2014, i hapur nga Drejtoria Komunale e Arsimit, në Komunën e Kamenicës, përgjegja në ankesën e I.K., nga Drejtoria Komunale e Arsimit, në Komunën e Kamenicës, me nr. 1016, e datës 21.11.2014, Përgjegja në ankesën e I.K., nga Komisioni Komunal për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave, me nr. 02-39072, e datës 27.11.2014, përgjegja në ankesën e I.K., nga Departamenti i Inspeksionit, sektori i inspeksionit të Arsimit në Gjilan, me nr.10/1-3, me nr. prot.346/2014, e datës 15.12.2014, Vendimi me nr. 198 i datës 03.04.2015, i lëshuar nga MASHT, Departamenti i Inspeksionit të Arsimit, Vendimi me nr.211284, i datës 15.05.2015, i lëshuar nga Zyra e sekretarit të përgjithshëm të MASHT, Aktvendimi mbi licensimin e mësimdhënësit me nr. prot.08/2012/2148, të datës 11.09.2012, i lëshuar nga sekretari i përgjishëm i MASHT, Lisenca e mësimdhënësit me nr.100002148, e lëshuar nga MASHT, Lexohet referenca me nr.99, e datës 23.02.2015, lëshuar nga Gjimnazi “Ismail Qemali” në Kamenicë, Kontrata e Punës me nr.32, e datës 01.09.2010, e lidhur në mes të DKA-së në Kamenicë dhe I.K. nga, Kontrata e punës me nr.34, e datës 04.09.2011, e lidhur në mes të DKA-së në Kamenicës dhe I.K. nga, Kontrata e punës me nr.669/37, e datës 01.09.2012 e lidhur në mes të DKA-së në Kamenicës dhe I.K. nga, Kontrata e punës me nr.850/22, e datës 17.09.2013, e lidhur në mes të DKA-së në Kamenicës dhe I.K. nga, Kontrata e punës me nr.784/09, e datës 04.09.2014, në mes të DKA-së në Kamenicës dhe I.K. nga, konkursi me nr.855, i datës 30.09.2014, i hapur nga DKA në Kamenicë, Vendimi me nr.10/1-3, i datës 06.12.2015, i lëshuar nga Zyra e Sekretarit të

përgjithshëm nga MASH, përgjegja në kërkesë e sektorit të Inspektoriatit të Arsimit në Gjilan ndaj Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, e datës 15.07.2016, Njoftimi me nr.19, i datës 19.01.2021, i lëshuar nga Gjimnazi “Ismail Qemali” në Kamenicë, tabela e lëndëve mësimore për vitin shkollor 2020/2021- klasa 11, njoftimi me nr.06, i datës 22.01.2021, i lëshuar nga DKA në Kamenicë, Informata me nr.27, e datës 19.01.2021, e lëshuar nga Gjimnazi “Ismail Qemali” në Kamenicë, përgjegja në kërkesë nga Inspektoriati i Arsimit ndaj Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë me nr. të prot.080/21, e datës 22.02.2021.

Gjykata ka konstatuar se në mes palëve ndërgjygjëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi I.K. ka punuar te e paditura si mësimdhënës i lëndëve ekonomike, por, kontestuese për të paditurën ishte baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit.

Në bazë të kontratës së punës 784/09, të datës 04.09.2014, të lidhur në mes punëdhënësit DKA në Kamenicë dhe punëmarrësit I.K., gjykata e vërtetoi faktin se paditësit me datën 31.08.2015, i ka skaduar kontrata e punës me afat të caktuar kohor dhe të njëjtit punëdhënësi nuk i kishte vazhduar më tutje.

Në bazë të njoftimit me nr.19, të datës 19.01.2021, i lëshuar nga Gjimnazi “Ismail Qemali” në Kamenicë, gjykata e vërtetoi faktin se në këtë shkollë lënda e ekonomisë është mësuar deri në vitin shkollor 2015/2016 në drejtimin shoqëror, si dhe u vërtetua edhe fakti se që nga 1 shtatori i vitit shkollor 2016/2017 sipas kurrikulës së re, lënda e ekonomisë është larguar nga planprogrami mësimor.

Në bazë të njoftimit me nr. 06, të datës 22.01.2021, e lëshuar nga DKA në Kamenicë, gjykata e vërtetoi faktin se lënda e ekonomisë si lëndë obligative dhe e rregullt mësimore është mësuar dhe ka qenë e paraparë në planprogramet mësimore të hartuara nga MASHT deri në vitin shkollor 2015/2016, përkatësisht deri më 31.08.2016, poashtu përmes këtij njoftimi gjykata e vërtetoi faktin se pozita e mësimdhënësit të mësimit zgjedhor për lëndë ekonomike nuk ekziston sepse kjo lëndë është larguar nga planprogrami mësimor.

Në bazë të përgjegjes në kërkesë me nr. Ref.10/6 dhe me nr. Prot.080/21, të datës 22.02.2021, nga Sektori i Inspektoriatit të Arsimit në Gjilan, gjykata e vërtetoi faktin se nga data 25.10.2016 nuk ekzistojnë lëndët ekonomike të rregullta si dhe në mësimin zgjedhor në Gjimnazin “Ismail Qemali” në Kamenicë.

Duke pasur parasysh që për plaët ndërgjygjëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësi I. K. ka punuar te e paditura DKA në Kamenicë, gjykata nuk e pa të nevojshme të provojë faktet për këtë çështje dhe nuk i vlerësojë provat e administruara.

3. Baza juridike

Duke u bazuar në nenin 71 paragrafi 2, të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212, ku përcaktohet se *“Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën*

me periudhë të caktuar duhet të informojë punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë”, si dhe në nenin 72 paragrafi 1, të po këtij ligji, ku përcaktohet se “Vendimi për të ndërprerë kontratën e punës duhet të bëhet me shkrim dhe duhet të përfshijë arsyetimin për ndërprerje”, gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret punëdhënësi DKA në Kamenicë, nuk i ka respektuar procedurat paraprake para ndërprerjes së marrëdhënies së punës ndaj punëmarrësit I.K., e as nuk e ka njoftuar me shkrim të njëjtin për arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Ndërsa duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 1 pika 1.1, të Ligjit të Punës, ku përcaktohet se “Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit” dhe meqenëse është vërtetuar se të punësuarit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme, gjykata ka gjetur se në rastin konkret paditësit duhet t'i kompensohet një pagë mujore në vlerë prej 418.00 euro për periudhën 30 ditore pas datës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe e ka detyruar të paditurën DKA në Kamenicë t'a bëjë kompensimin e kësaj page mujore për faktin se e njëjta nuk e ka respektuar procedurën paraprake para ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punësuarit.

Ndërsa duke u bazuar në nenin 67 paragrafi 1 pika 1.3, të Ligjit të Punës, ku përcaktohet se “Kontrata e punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet, me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës”, si dhe duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 1 pika 1.2 të po këtij ligji, ku përcaktohet se “nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna”, dhe pas administrimit dhe vlerësimit të provave materiale gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret paditësit I.K. i ka skaduar kontrata sipas fuqisë ligjore me datë 31.08.2015, ngase i njëjti ka pasur kontratë me periudhë të caktuar kohore, poashtu gjykata ka vërtetuar faktin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjë lloj të diskriminimit ndaj paditësit, e rrjedhimisht gjykata nuk mund t'a kthejë të njëjtin në vendin e tij të punës dhe ka vendosur që këtë pjesë të kërkesëpadisë të paditësit të refuzojë si të pabazuar.

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke i marrë parasysh të gjitha provat materiale të administruara dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata erdhi në përfundim se padia dhe kërkesëpadija e paditësit I.K., pjesërisht është e bazuar, ngase gjykata ka vërtetuar faktin se vendimi mbi ndërprerjen e

marrëdhënies së punës të cekur si në pikën I të këtij dispozitivi është marrë në kundërshtim me dispozitën e neneve 71 paragrafi 2 dhe 72 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, kjo për faktin se e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, në Komunën e Kamenicës, nuk e ka zbatuar fare procedurën paraprake ndaj punëmarrësit I.K., ashtu siq e obligojnë dispozitat e lartëcekura, respektivisht punëdhënësi DKA në Kamenicë, ka dështuar që gjykatës t'ia vërtetojë me prova relevante faktin se i ka zbatuar procedurat paraprake para ndërprerjes së marrëdhënies së punës, të punësuarit I.K.. Pra, DKA në Kamenicë, si punëdhënëse nuk e ka njoftuar punëmarrësin I.K. 30 ditë para datës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës, e poashtu nuk e kishte njoftuar me shkrim për arsyet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Andaj, meqenëse nuk janë respektuar këto procedura paraprake para ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nga punëdhënësi DKA në Kamenicë ndaj punëmarrësit I.K., gjykata ka vërtetuar se në rastin konkret paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura si më lartë dhe për këtë arsye duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Punës, e ka obliguar të paditurën që paditësit t'ia kompensojë një pagë mujore prej 418.00 euro duke llogaritur periudhën kohore prej 30 ditësh shtesë, pas datës së ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ashtu siq e përcakton edhe neni 71 paragrafi 2 i Ligjit të Punës, e duke e pasur parasysh që e paditura në rastin konkret ka dështuar t'i zbatojë dispozitat ligjore të përmendura më lartë, gjykata erdhi në përfundim dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pjesës tjetër të kërkespadsisë së paditësit, përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura që ta kthej në vendin e tij të punës si mësimdhënës i lëndëve ekonomike dhe t'ia kompensojë të ardhurat personale nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në kthimin në punë, gjykata ka vendosur që këtë pjesë të kërkespadsisë së paditësit ta refuzojë si të pabazuar, për faktin se duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit të Punës, gjykata është e autorizuar ta ekzekutojë vetëm dëmshpërblimin adekuat në të holla për punëmarrësin, të cilit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme, e jo edhe të detyrojë punëdhënësin që të njëjtin t'a kthejë në vendin e punës. Ndërsa gjykata është e autorizuar që të kthejë në vendin e tij të punës punëmarrësin sipas nenit 80 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit të Punës vetëm kur vërteton faktin se largimi nga puna është i kundërligjshëm sipas nenit 5 të Ligjit të Punës, i cili nen i referohet diskriminimit në vendin e punës (sipas Ligjit kundër Diskriminimit), e që në rastin konkret gjykatës i rezultojë se nuk kemi të bëjmë me ndonjë lloj të diskriminimit në vendin e punës të pësuar nga paditësi. Përveq këtyre, është vlerësim i kësaj gjykate se themelimi i marrëdhënies së punës me kontratë dhe përcaktimi i kushteve të punës i referohet normave ligjore të karakterit dispozitiv, duke i lejuar palëve të drejtën por pa i cenuar dispozitat ligjore, t'i përcaktojnë kushtet e kontratës, përfshirë këtu edhe kohëzgjatjen e kontratës, e sipas këtyre është plotësisht në vullnetin e punëdhënësit themelimi rishtazi apo ripërtitja e marrëdhënies së punës me paditësin, e deri në këtë përfundim gjykata ka ardhur duke pasur parasysh faktin se punëmarrësi I.K. ka pasur kontratë me periudhë të caktuar kohore dhe atë deri më 31.08.2015, të cilit i është ripërtirë çdo vitë kontrata e punës duke filluar nga 01.09.2010, e që pas datës 31.08.2015, paditësit I. K. i ka skadur kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërsa në rastin konkret punëdhënësi DKA, të njëjtit nuk i'a kishte vazhduar më tutje marrëdhënien e punës. Meqenëse, gjykata paditësit I. K. i'a ka refuzuar kërkesën për kthimin në vendin e tij të punës si mësimdhënës i lëndëve ekonomike,

rrjedhimisht të njëjtit i'a ka refuzuar edhe kërkesën për kompensimin e të ardhurave personale nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në kthimin në vendin e tij të punës si të pabazuar, për faktin se paditësi ka pasur kontratë me periudhë të caktuar kohore dhe me skadimin e kontratës sipas fuqisë ligjore, DKA në Kamenicë si punëdhënëse nuk i'a kishte vazhduar më tutje kontratën e punës paditësit I.K., e që në rastin konkret i njëjti nuk ka punuar gjatë kësaj periudhe kohore e poashtu në rastet e tilla gjykata nuk mund ta kthejë paditësin në vendin e tij të punës, përveq në rastet kur kemi të bëjmë me diskriminim në vendin e punës, të njëjtit nuk i takon kompensimi i të ardhurave personale për periudhën kohore për të cilën i ka kërkuar e duke i marrë parasysh të gjitha të lartëcekurat, gjykata ka ardhur në përfundim që këtë pjesë të kërkespadiës ta refuzojë si të pabazuar dhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke i marrë parasysh udhëzimet dhe rekomandimet e Gjykatës së Apelit të Kosovës, të dhëna përmes aktvendimit Ac.nr.3891/17, të datës 09.09.2020, për vërtetimin e fakteve relevante, sipas detyrës zyrtare i ka nxjerrë provat materiale siq është njoftimi me nr. 06, i datës 22.01.2021, i lëshuar nga DKA në Kamenicë, përmes së cilit gjykata vërtetoi faktin se lënda e ekonomisë si lëndë obligative dhe e rregullt mësimore është mësuar dhe ka qenë e paraparë në planprogramet mësimore të hartuara nga MASHT deri në vitin shkollor 2015/2016, përkatësisht deri më 31.08.2016, poashtu përmes këtij njoftimi gjykata vërtetoi faktin se pozita e mësimdhënësit të mësimit zgjedhor për lëndë ekonomike nuk ekziston se kjo lëndë është larguar nga planprogrami mësimor, poashtu edhe përmes përgjegjes në kërkesë me nr.Ref.10/6 dhe me nr.Prot.080/21, të datës 22.02.2021, nga Sektori i Inspektoriatit të Arsimit në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se nga data 25.10.2016, nuk ekzistojnë lëndët ekonomike të rregullta si dhe të mësimin zgjedhor në Gjinnazin "Ismail Qemali" në Kamenicë. Andaj kjo gjykatë në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar faktin se vendi i punës si mësimdhënësi i lëndës ekonomike në Gjinnazin "Ismail Qemali" në Kamenicë, ku po kërkon paditësi të kthehet nuk ekziston më si vend i punës, e poashtu nuk ekzistonë më në kurrikulën e re shkollore lënda e ekonomisë, të cilën lëndë e ka ligjëruar paditësi më pare dhe atë që nga 1 shtatori 2016. Por duke i marrë parasysh të gjitha të lartëcekurat gjykata konstaton se vërtetimi i këtyre fakteve tani më është i panevojshëm dhe nuk kanë asnjë lloj relevance sepse ka kaluar një periudhë e gjatë kohore dhe kanë ndryshuar rrethanat si dhe gjendja faktike, e si të tilla nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike kontestimore nga gjykata.

Gjykata, në shqyrtimin kryesor administrojë edhe prova tjera materiale por, që të njëjtat nuk i morri për bazë me rastin e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, ngase të njëjtat ishin pa ndikim në vërtetimin e fakteve të pretenduara nga palët ndërgjyqjese.

5. Shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në dispozitën e nenit 452, paragrafi 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe vendosi që secila palë t'i

bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, ngase secila palë ndërgjyqjese ka pasur sukses të pjesshëm në procesin gjyqësor.

Duke u bazuar në dispozitën e nenit 143, të Ligjit për Procdurën Kontestimore, e lidhur me dispozitat e neneve 67, 71, 72 dhe 80 të Ligjit të Punës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C. nr. 617/2020, i datës 01.04.2021

G j y q t a r i
Artan Abazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.